



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës **KSC-BC-2020-06**

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: **Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

 Gjykatës Nikola Giju

Administratore: **Dr. Fidelma Donlon**

Data: **12 korrik 2021**

Gjuha: **Anglishte**

Klasifikimi: **Publik**

Urdhër për caktimin e datës për mbajtjen e konferencës së gjashtë mbi ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtimeve

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të viktimave
Sajmën Loz

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Deivid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit (të quajtur bashkërisht "Mbrojtja").²

2. Më 12 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori "Vendim për kategorizimin e provave sipas rregullës 109(c) dhe çështje të lidhura me të", ku u urdhërua kategorizimi i materialit të rregullës 102(1)(b) sipas rrethanave të çështjes dhe afati për dorëzimin e tij u shty për datën 23 korrik 2021.³

3. Më 19 maj 2021, në pajtim me urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake⁴ për caktimin e datës, u mbajt konferenca e pestë ("Konferenca e pestë për ecurinë e çështjes"), ku ZSP-ja bëri të ditur se, sipas vlerësimit të saj më të fundit, dorëzimi i dosjes paraprake do të bëhet në mes të tetorit 2021.⁵

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i redaktuar publik i vendimit mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, publik; KSC-BC-2020-06, F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e redaktuar më tej*, 4 nëntor 2020, publike.

³ KSC-BC-2020-06, F00218, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për kategorizimin e provave sipas rregullës 109(c) dhe çështje të lidhura me të*, 12 mars 2021, publik, para. 22.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00300, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për caktimin e datës për konferencë mbi ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve*, 14 maj 2021, publik, para. 19.

⁵ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 19 maj 2021, publik, f. 420, rreshti 24 deri në f. 421, rreshti 3. Janë mbajtur katër konferenca për ecurinë e çështjes para saj, në intervale të rregullta, konkretisht më 18 nëntor 2020, më 17 dhjetor 2020, më 16 shkurt 2021, dhe më 24 mars 2021. *Shih* KSC-BC-2020-06, F00074, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për caktimin e datës për konferencë mbi ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve*, 11 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike; Transkript i seancës, 18 nëntor 2020, publik; F00130, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për caktimin e datës së*

4. Më 24 qershor 2021, në vijim të kërkesës së ZPS-së,⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake shtyu afatet kohore lidhur me materialin e rregullës 102(3).⁷

5. Më 8 korrik 2021, ZPS-ja paraqiti kërkesën e saj të tetë për masa mbrojtëse.⁸

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Sipas rregullës 96(1) të Rregullores, në vijim të konferencës së parë për ecurinë e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencat pasuese për ecurinë e çështjes, në qoftë se e gjykon të nevojshme, për: (i) organizimin e shkëmbimeve mes palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave për të shpejtuar përgatitjet për gjykim; (ii) ndërmarrjen e hapave për të mundësuar çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes për t'u dhënë palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtjes së viktimave, mundësinë e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

7. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, Të gjitha provat ose faktet materiale dhe relevante që i posedon Zyra e Prokurorit të Specializuar të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit vihen në dispozicion të të akuzuarit para fillimit të procedurës dhe gjatë saj, dhe i nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që janë rreptësisht të nevojshme dhe atëherë kur zbatohen mbrojtjet e nevojshme kundër-balancuese. Në

konferencës së dytë për ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve, 8 dhjetor 2020, publik; Transkript i seancës, 17 dhjetor 2020, publik; F00185 Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Urdhër për caktimin e datës së konferencës së tretë për ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve 3 shkurt 2021, publik; F00193, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Urdhër për ndryshimin e datës së konferencës së tretë për ecurinë e çështjes, 9 shkurt 2021, publik; Transkript i seancës, 16 shkurt 2021, publik; Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Urdhër për caktimin e datës së konferencës së katërt për ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve, 17 mars 2021, publik; Transkript i seancës, 24 mars 2021, publik.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00356, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për shtyrjen e afateve kohore për të bërë njoftim të rregullës 102(3)*, 18 qershor 2021, publike.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00370, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi kërkesën e Prokurorisë për shtyrjen e afateve kohore për të bërë njoftim të rregullës 102(3)*, 24 qershor 2021, publik, par. 16.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00387, Prokurori i Specializuar, *Kërkesa e tetë për masa mbrojtëse*, 8 korrik 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-18, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

pajtim me rregullën 102 (3) të Rregullores, ZPS-ja i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes mbi çdo material dhe provë që ka në zotërim.

8. Në pajtim me rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të paraqesë, brenda një afati të përcaktuar: (i) dosjen paraprake, duke përfshirë çdo praninë nga Mbrojtja dhe një listë të pikave të pakontestuar: (ii) listën e dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar synon të thërrasë; dhe (iii) listën e provave materiale të propozuara që Prokurori i Specializuar synon të paraqesë, ku përfshihet, kurdoherë që është e mundur, çfarëdo kundërshtimi i Mbrojtjes lidhur me autenticitetin e këtyre provave.

9. Në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve sipas rregullës 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e fton Mbrojtjen të paraqesë dosjen paraprake brenda një afati të caktuar. Gjithashtu, brenda një afati të caktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja e njofton ZPS-në për synimin e saj për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale, ndër të cilat aftësinë mendore të kufizuar, ose mungesën e aftësisë mendore, intoksikimin, shtrëngimin, domosdoshmërinë, dhe gabime faktike ose ligjore.

10. Në pajtim me rregullën 96 (2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit pas marrjes së këshillave nga mbrojtësi, mund të zhvillohet një konferencë për ecurinë e çështjes gjyqësore: (i) në praninë e të akuzuarit, me mbrojtësin që merr pjesë përmes videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit, me të akuzuarin që merr pjesë përmes videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit, me mbrojtësin të pranishëm ose që merr pjesë përmes videokonferencës. Gjithashtu, çdo kërkesë për pjesëmarrje në konferencën për ecurinë e çështjes gjyqësore përmes videokonferencës i paraqitet drejtpërsëdrejti Administratores, në përputhje me Udhëzuesin e Punës së Administratores për Videolidhjet (KSC-BD-23/COR), paraprakisht e në kohë të

mjaftueshme, në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur, ku përfshihet edhe informimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake.⁹

III. DISKUTIM

11. Pasi ka shqyrtuar preferencat për datat të shprehura nga palët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake organizon konferencën e gjashtë për ecurinë e çështjes gjyqësore në fjalë, të mërkurën, më 21 korrik 2021, në orën 14:30.

12. Gjatës seancës Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë nga palët të bëjnë përditësimet e tyre, nëse kanë, për pikat e mbetura ende të pazgjidhura nga konferenca e pestë për ecurinë e çështjes gjyqësore, si dhe parashtrimet me shkrim dhe me gojë që kanë bërë lidhur me pikat e pazgjidhura. Konkretisht dhe përveç kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë përditësime për pikat vijuese sipas rendit të paraqitur më poshtë:

(1) Nxjerrja e materialeve:

- a. Çfarë përparimi është bërë në nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(b) prej ZPS-së brenda afatit 23 korrik 2021, në veçanti, si dhe duke mbajtur parasysh afrimin e datës, edhe sa material mbetet ende për t'u nxjerrë dhe a synon ZPS-ja të parashtojë kërkesa të tjera për masa mbrojtëse për materialin shtesë sipas rregullës 102(1)(b); nëse po, cili është afati realist që ZPS-ja të përmbushë detyrimin për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(b);
- b. Nëse ZPS-ja është brenda planit për t'i dhënë Mbrojtjes një njoftim të hollësishëm për materialet sipas rregullës 102(3) të Rregullores, deri të premtën, datë 30 korrik 2021;

⁹ Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00062, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për autorizim të pjesëmarrjes përmes videolidhjes*, 6 nëntor 2020, publik, para. 10; F00069, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për autorizim të pjesëmarrjes përmes videolidhjes*, 9 nëntor 2020, publik, para. 9.

- c. Nëse ka ende prova shfajësuese që ZPS-ja ka në ruajtjen, kontrollin apo në dijeninë e vet faktike që duhet t'i bëhen të ditura Mbrojtjes, sipas rregullës 103 të Rregullores, dhe nëse ndonjë nga këto kërkesa për masa mbrojtëse për material të tillë do të jetë e menjëhershme; dhe
- d. Nëse palët po përballen ose parashikojnë të përballen me ndonjë vështirësi lidhur me procesin e nxjerrjes së materialit sipas rregullës 107 dhe nëse do të bëhet ndonjë kërkesë e menjëhershme në pajtim me këtë rregull..

(2) Përkthimet:

- a. Nëse Njësia e Përkthimit ka përparuar me përkthimin e dokumenteve që kanë përparësi; dhe
- b. Nëse palët kanë paraqitur ndonjë kërkesë tjetër urgjente për përkthim.

(3) Hetimet e ZPS-së dhe hapat e mëtejshëm:

- a. Nëse ZPS-ja mund të ofrojë përditësim të mëtejshëm për datën e parashikuar të përfundimit të hapave hetimorë të papërfunduar; dhe
- b. Nëse është ende i vlefshëm parashikimi i ZPS-së për dorëzimin, nga mesi i tetorit 2021, të dosjes paraprake dhe materialeve të tjera të lidhura me të sipas rregullës 95(4)(a)-(c) të Rregullores.

(4) Hetimet e Mbrojtjes dhe hapat e mëtejshëm:

- a. Nëse Mbrojtja mund të ofrojë informacion të mëtejshëm mbi ecurinë e hetimeve të tyre;
- b. Po ashtu, nëse Mbrojtja mund të ofrojë më shumë informacion lidhur me synimin për të bërë kërkesa për mundësi hetimore unike, në përputhje me rregullën 99(1) të Rregullores; dhe

- c. Nëse Mbrojtja mund të ofrojë më shumë informacion lidhur me synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores, dhe çdo nxjerrje të lidhur të dokumenteve, në përputhje me rregullën 104(1) dhe (2) të Rregullores.

(5) Pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen:

- a. Nëse palët kanë pasur diskutime të mëtejshme *inter partes* për evidentimin e listës së pikave që janë objekt i mospajtit ndërmjet palëve dhe të atyre që nuk janë objekt mospajtit.

(6) Paraburgimi:

- a. Nëse shkëmbimi i dokumenteve mes Mbrojtjes dhe të akuzuarit në objektin e paraburgimit është përmirësuar si rezultat i përditësimit të rregulloreve të Kovid-19; dhe
- b. Nëse Zyra Administrative do të mund të rifillojë në muajin korrik vizitat prej anëtarëve të familjes së afërt.

13. Së fundmi, duke mbajtur parasysh disponueshmërinë e sallës së gjyqit në muajin shtator, palëve dhe pjesëmarrësve do t'iu kërkohet të bëjnë të ditur disponueshmërinë e tyre më 13 ose 14 shtator 2021 për konferencën e ardhshme për ecurinë e kësaj çështje gjyqësore.

14. Ftohen palët dhe pjesëmarrësit të paraqesin parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, lidhur me sa më sipër. Në rast se palët ose pjesëmarrësit dëshirojnë të ngrenë ndonjë çështje tjetër në konferencën e ardhshme për ecurinë e çështjes, e cila nuk është përfshirë në këtë urdhër, , atëherë ata ftohen t'i përfshijnë këto çështje në parashtrimet e tyre me shkrim. Palët dhe pjesëmarrësit ftohen t'i paraqesin këto parashtrime deri të premtën, 16 korrik 2021.

IV. VENDIM

15. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **VENDOS** të mbledhë një konferencë mbi ecurinë e çështjes në prani të ZPS-së, Mbrojtjes së viktimave dhe Mbrojtjes, të mërkurën, 21 korrik 2021, në orën 14:30; dhe
- b. **KËRKON** nga palët dhe pjesëmarrësit të paraqesin parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, deri të premtën, 16 korrik 2021, sikurse përcaktohet në paragrafin 14.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 12 korrik 2021
Në Hagë, Holandë.